



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr.Regj.Them. 771

VENDIM
“PËR HEQJEN E SEKUESTROS PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE: BLERINA MUÇA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Valbona Sadiku, në Tiranë, datë 05.10.2016, shqyrtoi kërkesën penale me Nr. 771 Regj.Them. që i përket:

KËRKUES:

J. B. N., i biri i A. dhe A., dtl. 12.07.19., lindur në Busan, Kore, me banim në Norvegji, me adresë: Rruga “...”, Nr. 8, 3185, ..., me pasaportë norvegjeze nr. 2...3, shtetas norvegjez, përfaqësuar fillimisht nga av. Denion Bogdani, nëpërmjet prokurës së posaçme Nr. 737 Rep. Nr. 347 Kol. datë 19.04.2016 dhe nga av. Ardian Visha, nëpërmjet prokurës datë 06.09.2016, lëshuar në Pasig City, Republika e Filipineve.

Me pjesëmarrjen e Prokurores Antoneta Sevdari, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mungesë në shpalljen e vendimit.

OBJEKTI :

Heqjen e masës së sekuestros, vendosur mbi llogarine e J. B. N., pranë “Intesa SanPaolo Albania Bank” sha, me Vendimin datë 21.03.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE :

Nenet 210 dhe 212 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën dhe aktet e administruara në gjykim, në pretendimet e fundit, dëgjoi palën kërkuese që kërkoi pranimin e kërkesës, prokuroren që kërkoi rrëzimin e kërkesës,

VËREN

Kërkuesi J. B. N., shtetas norvegjez, pasi ka rënë në dijeni të Vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 21.03.2016, “Për sekuestrimin e llogarive bankare”, nëpërmjet kërkesës në shqyrtim, depozituar në këtë Gjykatë në datën 16.05.2016, kërkon heqjen e kësaj mase sekuestro, duke pretenduar kryesisht sa më poshtë:

- Në momentin e vendosjes së sekuestros mbi llogaritë bankare të kërkuesit, nuk ka ekzistuar asnjë element që do të mund të bazonte dyshimin ndaj kërkuesit;
- Kërkuesi, në situatën në shqyrtim, nuk mund të ngarkohet me barrën e provës në drejtim të legjitimitetit të burimit të parave të sekuestruara, në një kohë kur këtë detyrim ligjor, e ka Prokuroria, e cila minimalisht, për vendosjen e sekuestros, duhej ta mbështeste dyshimin qoftë edhe mbi vetëm një provë;
- Në vendimin e sekuestros, shtrembërohet e vërteta mbi kërkuesin dhe nuk paraqiten informacionet që disponoheshin në momentin e nxjerrjes së këtij akti. Për më tepër, edhe pas 6 muajve hetim, Prokuroria nuk është në gjëndje të paraqesë një element të shtuar, në mbështetje të vendimit të sekuestros;
- Prokuroria nuk justifikon ngutshmërinë në lëshimin e vendimit objekt gjykimi. Regjistrimi i çështjes penale, rezulton të jetë bërë me shpresën e sigurimit të ndonjë prove në të ardhmen, veprim i cili është në kundërshtim me ligjin dhe me pasoja të rënda në drejtim të ushtrimit të ligjshëm, të lirshëm dhe të drejtë të biznesit nga një shtetas i huaj, që sjell në këtë vend para dhe synon investimin përkatës;
- Vetë Prokuroria pohon se nuk disponon asnjë provë për kryerjen e ndonjë vepre penale nga kërkuesi, fakt i cili e bën të papranueshëm vendimin e saj të datës 21.03.2016;
- Nga aktet provuese të paraqitura nga kërkuesi, rezulton se ai është pa precedentë penal. Gjithashtu, nga këto prova konfirmohet qëllimi i projektit tërësisht në përputhje me ligjet e RSH-së.

Nga përfaqësuesja e Prokurorisë, u kërkua rrëzimi i kërkesës së kërkuesit O. J., duke argumentuar sa më poshtë:

- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rregjistruar proçedimin penal nr. 2533 të vitit 2016, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, mbi bazën e informacioneve të sjella nga instucionet ligjzbatuese për transkionet financiare të dyshimta të kryera ndërmjet personave të cilat dyshohen se kanë kryer veprimtari kriminale.
- Në kushtet e urgjencës, për shkak se një pjesë e parave është kërkuar të transferohet jashtë vendit, është nxjerrë urdhëri i sekuestrimit të parave të ndodhura në llogari bankaredatë 21.03.2016. Në datën 21.04.2016, Drejtoria e Policisë së Shtetit ka përcjellë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të dhëna të marra nga institucionet homologe të Republikës së Kosovës dhe Ambasadës së Danimarkës, mbi dënimet penale të dhëna ndaj shtetasve O. J.O. J.dhe J. B. N..
- Me Urdhërin e datës 22.04.2016, është urdhëruar regjistrimi i emrave të shtetasve O. J.O. J.dhe J. B. N. në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, si persona të dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”. Dyshimet e deritanishme bazohen në aktet e fashikullit hetimor, nga ku rezulton se:
 - Në muajin nëntor të vitit 2015, është themeluar në Norvegji, Shoqëria “N... G... D... AS” me një kapital themeltar prej 30.000 (tridhjetëmijë) korona norvegjeze, ekuivalente e rreth 3.800 (tremijë e tetëqind) Euro, me menaxher kryesor J. K.J. K.dhe me anëtar të Bordit të Drejtorëve G. E.. Kjo shoqëri është regjistruar në regjistrin e shoqërive në Bronnoysund, në datën 15.12.2015. Në datë 27 Janar 2016, është nënshkruar në Tiranë, një kontratë për shitjen e 5% të aksioneve të shoqërisë norvegjeze të sipërcituar tek shtetasi norvegjez G. E., për vlerën 150 Euro dhe 90% të aksioneve tek shtetasi tjetër norvegjez O. J., për një shumë prej 2.700 Euro. Dy muaj më pas, shtetasi nën hetim O. J.O. J., ka shitur 40% të këtyre aksioneve në vlerën 600.000 Euro, tek shtetasi J. B. N.. Pra, pa u investuar asgjë në shoqëri, vlera e aksioneve të saj, brënda tre muajve, është rritur mbi 500 herë.
 - Në Shqipëri, në datën 02.02.2016, është krijuar shoqëria me të njëjtin emër “N... G... D...” shpk. Në datën 16.03.2016, shoqëria Norvegjeze “N... G... D...N... G... D... AS”, ka blerë të gjitha kuotat e shoqërisë shqiptare “N... G... D...N... G... D...” shpk, për vlerën prej 100.000 Lekë.
- Gjithashtu, në Shqipëri është krijuar edhe një shoqëri tjetër, nga shtetasi J. B. N., me emrin “A... C... Group”, e regjistruar në datë 02.03.2016, me NIPT L6...8M, me aksionar të vetëm J. B. N. dhe me objekt veprimtarie “*Dizenjim, projektim zbatim i projekteve të ndryshme inxhinjerie. Zhvillim dhe ndërtim i projekteve multi funksionale. Konsulencë në fushën e tregtisë dhe ligjit. Shitje, tregti, import-export, me pakicë e shumicë të mallrave të ndryshme, për vete dhe për të tretë. Mallra ushqimore dhe industriale...etj.*”

- Shtetasi O. J., ka hapur llogari bankare në Bankën “Intesa SanPaolo Albania” sha në Shqipëri dhe në datat 02.03.2016 dhe 08.03.2016, në llogarinë e tij ka mbërritur një transfertë me vlerë 200.000 Euro nga Filipinet. Banka dërguese është “Union Bank of Filippines”. Dërguesi i fondeve është **J. B. N. dhe detajet e transfertës janë “Investim kapitali”**.
- Në datë 16.03.2016, shtetasi O. J.O. J.ka kërkuar të kryejë një transfertë me vlerë 100.000 Euro për në Serbi, në favor të përfituesit D. S.. Më tej, në datë 17.03.2016, O. J.O. J.ka kërkuar të anulohet kjo transfertë, duke deklaruar se e ka kryer transferimin e këtyre fondeve nga burime të tjera, pasi e kishte urgjente. Detajet e transfertës janë “Kredi”. Në lidhje me transfertën prej 100.000 Euro, ky shtetas ka paraqitur një marrëveshje kredie mes palëve e datës 12.03.2014, sipas të cilës O. J.O. J.është kredihënësi dhe shtetasi D. S. me Nr. personal ID 1...6, nga Beogradi, është kredimarrësi. Nga shpjegimet që ka dhënë O. J., përfituesi i fondeve është bashkëpunëtor në biznes si avokati i tij.
- Shtetasi Norvegjez J. B. N., ka hapur llogari bankare personale në Shqipëri dhe më datë 08.03.2016, në llogarinë e tij ka mbërritur një transfertë nga Filipinet me vlerë 300.000 Euro. Dërguesi i transfertës është vetë J. B. N. dhe detajet e transfertës janë “Investim kapitali”. Banka dërguese është “Banka e Bashkuar e Filipineve”.
- Nga informacionet policore rezulton se shtetasi O. J. është dënua në Kosovë për veprën penale të “Mashtimit” nga Gjykata e Prishtinës, me dy vjet burg dhe pagesë të dëmit prej 300.000 Euro, nën akuzën se ka përvetësuar shumën prej 300.000 Euro nga Kompania Shtetërore e Postës dhe Telekomunikacionit në Kosovë. Aktiviteti i tij shtrihet, përveç Norvegjisë, edhe në Prishtinë, Kosovë dhe Serbi.
- Nga informacionet e policisë gjyqësore rezulton se, nga burime të hapura të informacionit, J. B. N. është përfshirë në aktivitetin e skemave piramidale “Unaico”, e cila është themeluar nga J. T., shtetas norvegjez dhe drejtuar nga disa norvegjezë dhe suedezë, ndër të cilët edhe shtetasi norvegjez J. B. N.. Gjithmonë sipas këtyre informacioneve, N. është ish-kryetari i kompanisë T... B.... Sipas burimeve të mediave të shkruara, “Unaico” nuk di të thotë se ku ndodhet J. B. N., i cili ishte personi përgjegjës për menaxhimin e parave dhe se shumë norvegjezë kanë humbur paratë e tyre si pasojë e këtyre mashtrimeve.
- Në datën 03.02.2016, është nënshkruar një Kontratë Huaje ndërmjet shoqërisë “N... G... D...”, si huamarrëse dhe shtetasit O. O. J., si huadhënës, për një shumë huaje në vlerën 800.000 Euro, për një afat një vjeçar, pa interesa.
- Nga dokumentacioni i administruar deri në këtë moment në procedimin penal, egzistojnë dyshime të arsyeshme se shtetasit O. J.O. J.dhe J. B. N., kanë kryer veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale apo

veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në këto kushte vendimi i sekuestrimit të parave të ndodhura në llogaritë bankare të këtyre shtetasve, është marrë në perputhje me detyrimet ligjore të parashikuara nga neni 210 i Kodit të Proçedurës Penale, për shkak se dyshohet se këto para, janë produkt i veprës penale, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Dyshimet për kryerjen e veprës penale mbështeten në faktet e poshtëshënuara:

- Nga të dhënat e administruara nga institucionet homologe të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, rezulton se, personat e përfshire në këto transaksione bankare janë persona të dënuar për një sërë veprash penale: shtetasi O. J.O. J. është dënuar për një sërë veprash penale në Norvegji dhe në Kosovë, që kanë të bëjnë me krim financiar, mashtrime me tvsh, vjedhje në rrethana rënduese, mashtrim. Madje, nga një informacion i marrë kohët e fundit, rezulton se ky shtetas, edhe aktualisht, ndodhet nën hetim në Norvegji për krime financiare.
- Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit të krijohet bindja se ky dokumentacion është tërësisht fiktiv dhe i prodhuar në funksion të veprës penale të “Pastrimit të parave apo veprimtarisë kriminale. Fiktiviteti i këtyre dokumentave rezulton nga analiza e fakteve të këtyre dokumentave por edhe nga forma e tyre.
- Kështu shoqëria “N... G... D...” shpk, është themeluar në 02.02.2016, me Nipt L6...7D, me administrator dhe ortak të vetëm shtetasin norvegjez J. K., me seli në Njësia Bashkiake nr. 10, Tiranë, me objekt të veprimtarisë “Zhvillimi, ndërtimi, investimi dhe menaxhimi i resorteve turistike, fushave të golfit, etj”, me kapital themeltar 100.000 Lekë. Nga verifikimi i situatës financiare të subjektit nëpërmjet dokumentacionit të depozituar nga ana e kësaj shoqërie pranë DRT Tatimore Tiranë, ka rezultuar se ky subjekt tregtar nuk ka të depozituar asnjë dokumentacion në arshivën e DRTT. Gjithashtu për këtë shoqëri është kryer edhe verifikimi në vendushtrimin e aktivitetit, ku është konstatuar se, në adresën e deklaruar, është selia qendrore e Studios Ligjore “L...” shpk me Nipt L4...1G. Oficerët e Policisë Gjyqësore kanë kontaktuar shtetasin S. L., i cili ka sqaruar se, selia e kësaj shoqërie, është vendosur në adresën e zyrës së tij, vetëm efekt të regjistrimit fillestar, duke qënë se ka qënë kjo studio ligjore, që ka dhënë konsulencë ligjore fillimisht dhe më pas, është marrë me regjistrimin e kësaj shoqërie pranë QKR. Pra, shoqëria në fakt, nuk e ka selinë në këtë adresë, nuk ka asnjë adresë në të cilën ushtron aktivitet, si dhe nuk ka ushtruar aktivitet për asnjë ditë.
- Shoqëria është rregjistruar si biznes i vogël, ndërkohë që pretendon se do të kryejë investime deri në 800.000 Euro, vetëm për katër muaj, nga 02.02.2016-02.06.2016 (O. J.O. J.i ka paraqitur oficerit të policisë gjyqësore planin e investimit). Referuar deklarimeve në tatime nga shoqëria, rezulton

se kjo shoqëri nuk ka kryer as shitje dhe as blerje. Është kqyrur sistemi, në rubrikën që jepen të dhëna për listëpagesat e të punësuarve të këtij subjekti, ku është kqyrur dhe administruar informacioni, nga ku është konstatuar se ky subjekt, ka deklaruar në listëpagesën e muajit shkurt 2016, vetëm administratorin e shoqërisë, shtetasin J. K., si të punësuar. Pra, nga të gjitha verifikimet e kryera për këtë shoqëri tregtare, konstatohet se ajo, deri më tani, nuk ka një aktivitet real, pra nuk ka veprimtari tregtare, nuk ka punësuar asnjë punonjës, nuk ka një zyrë reale, nuk ka as kompjuter as paisje kancelarie etj.

- Shoqëria “N... G... D... AS” në Norvegji, është bërë ortakë e vetme e shoqërisë me të njëjtin emër, regjistruar në QKB në datën 02.02.2016. Kalimet e kuotave në shoqërinë norvegjeze, janë realizuar nëpërmjet kontratave të përpiluara në Tiranë. Në datën 27 Janar 2016, është nënshkruar në Tiranë një Kontratë për Shitjen e 5% të aksioneve të shoqërisë norvegjeze tek shtetasi norvegjez G. E., për vlerën 150 Euro dhe 90% të aksioneve, tek shtetasi tjetër norvegjez O. J., për një shumë prej 2.700 Euro. Dy muaj më pas, 40% e këtyre aksioneve, janë shitur nga O. J.O. J.tek J. B. N., me çmim 600.000 Euro. Pra, pa asnjë investim në shoqëri, vlera e aksioneve të saj, brenda tre muajve, është rritur rreth 500 herë. Blerja lirë dhe shitja shtrenjtë e aksioneve të një shoqërie, njihet si skemë e përdorur në pastrimin e parave që vijnë nga një aktivitet i paligjshëm financiar;
- Përveç kësaj, dokumentacioni i paraqitur është kontradiktor për shkak se shtetasi O. J., nga njëra anë deklaroi se shuma e parave të sekuestruara në llogarinë e tij, janë për zhvillimin e aktivitetit të tij në Shqipëri, sipas objektit të veprimtarisë dhe, nga ana tjetër, kërkon t’i transferojë në Serbi, në formë huaje tek një shtetas, i cili, edhe sipas këtij dokumentacioni të paraqitur, nuk rezultoi të këtë lidhje me projektin. Në momentin që në bankë i është kërkuar dokumentacioni justifikues për këtë transfertë, shtetasi O. J.O. J.e ka refuzuar atë;
- Shtetasi O. J., i ka paraqitur Oficerit të Policisë Gjyqësore një deklaratë të shtetasit nën hetim J. B. N., në lidhje me paratë e transferuara, nga ky i fundit nëpërmjet “Union Bank of Filippines”. Institucionet homologe të hetimit të Mbretërisë së Norvegjisë, kanë informuar mbi llogaritë e shtetasit J. B. N. në Norvegji dhe në Kinë (si shtetas norvegjez), por ata nuk kanë dhënë asnjë informacion mbi llogaritë e këtij shtetasi në Filippine. Në deklaratën e tij, shtetasi J. B. N. deklaroi se, shuma është dërguar nëpërmjet “Deutsche Bank AG”. Nga swifti respektiv rezultoi qartë se, banka urdhëruese është “Union Bank of Filippines” dhe banka përfituese është “Intesa Sannpaolo Bank Albania” sha. Janë vetëm këto dy banka që kanë përgjegjësinë e verifikimit të dokumentacionit. “Deutsche Bank AG” në rastin konkret, nuk ka asnjë detyrim mbi verifikimin e dokumentacionit të transaksionit të kryer. Kjo bankë ka shërbyer vetëm si bankë ndërmjetëse për transferimin e fondeve ndërmjet dy bankave të sipërcituara dhe

marrëdhënia e saj është vetëm me bankat dhe jo me klientin dhe dokumentacionin e paraqitur prej tij.

- Shtetasi nën hetim O. J. deklaroi në seancën e datës 22.04.2016 në Gjykatë se për realizimin e projektit janë shpënzuar prej tij, deri në momentin që ai deklaroi 1.000.000 Euro. Ky shtetas nuk paraqiti as në gjykatë dhe as gjatë hetimit ndonjë faturë, apo transaksion bankar të kryer për pagimin e këtyre shpenzimeve dhe për më tepër, nuk deklaroi se cili është burimi i të ardhurave (shumës 1.000.000 Euro), që ai pretendon se ka harxhuar për realizimin e projektit. Vepra penale “Pastrimi të parave të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale” nuk kërkon patjetër një vendim dënimi. Mjafton të egzistojnë të dhëna të mjaftueshme, që krijojnë bindjen se paratë vijnë nga një veprimtari kriminale.
- Organi i Prokurorisë ka nisur kërkesat për ndihmë juridike në çështjet penale për autoritetet e Drejtësisë së Norvegjisë, Kosovës, Malit të zi dhe Filipineve, për marjen e të dhënave të tjera të domosdoshme në këtë procedim penal.

Duke u ndalur në analizimin e pretendimeve dhe provave të palës kërkuese, si dhe në argumentat e parashtruara më lart nga ana e Prokurorisë, Gjykata, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së kërkuesit O. J., e gjen atë të pabazuar për sa më poshtë:

- Në rastin konkret, ndodhemi në situatën përjashtuese të nenit 210 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon rregullin e përgjithshëm të vendosjes së masës së sekuestros konservative mbi llogaritë bankare, nëpërmjet vendimit të Gjykatës. Konkretisht, kjo dispozitë përcakton:

*“Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. **Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.**”*

- Në analizë të këtij parashikimi, është më se e qartë se, në situata të ngutshme, përjashtimisht nga rregulli i përgjithshëm, të drejtën e vendosjes së sekuestros mbi llogaritë bankare, kur dyshohet se ato kanë lidhje me një veprë penale, e ka organi i Prokurorisë. Vendimmarrja e këtij organi procedues, kalon nën kontrollin e Gjykatës, vetëm mbi ankimin e të interesuarit, i cili duhet të provojë dhe pretendimet e veta, në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të sekuestruara.

Në rastin objekt gjykimi, me Vendimin datë 21.03.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur sekuestrimin pranë “Intesa SanPaolo Albania Bank” sha, të shumave të parave të depozituara në llogaritë bankare të shtetasve O. J., J. B. N., të dy shtetas norvegjez, etj. në funksion të procedimit penal Nr. 2533/2016 për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Ky procedim, është regjistruar mbi bazën e materialit referues të Drejtorisë Vendore të Policisë, Tiranë. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, nëpërmjet shkresës me Nr. ... datë 18.03.2016, është lëshuar Urdhëri nr. 25 për “Intesa SanPaolo Albania Bank” sha, për bllokim të përkohshëm të transaksioneve mes shtetasve O. J., J. B. N., J. K., G. E. dhe shoqërive “N... G... D...” shpk dhe “A... C... G...” shpk, të regjistruara në QKB, Tiranë, respektivisht në datat 02.02.2016 dhe 02.03.2016.

- Nga tërësia e provave të administruara në gjykim rezulton se, në llogarinë bankare të çelur nga O. J.O. J. në emër të tij pranë kësaj Banke, në datat 02 dhe 08 Mars 2016, ka mbërritur shuma 200.000 Euro, si transfertë e kryer nga “Union Bank of Filippines”, nëpërmjet llogarisë së J. B. N. në këtë Bankë, me përshkrim veprimi “Investim kapitali”. Dyshimi fillestar mbi këtë transfertë, ka lindur për shkak të cilësimit të Filipineve, si një nga vendet e listuara si parajsa fiskale dhe, më pas, në momentin kur mbajtësi i llogarisë, kërkuesi O. J., ka kërkuar që nga shuma totale të transferojë shumën 100.000 Euro për në Serbi, me përfitues D. S.. Në momentin që nga ana e punonjësve të Bankës, i është kërkuar dokumentacion plotësues, O. J.O. J. e ka refuzuar transfertën e mësipërme. Më tej, këto dyshime shtohen edhe nga qëndrimi i shtetasit norvegjez O. J., i cili, nga njëra anë pretendon që shuma e mbërritur në llogarinë e tij, ka për qëllim investimin e saj në një projekt të konsiderueshëm për ngritjen e fushave të Golfit në Jug të Shqipërisë dhe, nga ana tjetër, justifikon urdhërimin e transfertës për në Serbi, me një marrëdhënie huaje, sipas Marrëveshjes së datës 12.03.2016, ku shtetasi O. J.O. J. ka pranuar t’i japë shtetasit D. S., brënda datës 31.03.2016, një hua në shumën 100.000 Euro, me afat 1 vjeçar, pa interes.
- Në bazë të Ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”, Udhëzimeve të Bankës së RSH-së dhe rregulloreve të bankave të nivelit të dytë në RSH, është detyrim i punonjësve të këtyre bankave, sinjalizimi sipas hierarkisë për transfertat në shuma të tilla, të ardhura nga bankat e vendeve të listuara si parajsa fiskale. Nga ana e Prokurorisë, u depozituan me cilësinë e provës, aktet e përpiluara nga punonjësit e Bankës për këtë qëllim.
- Sipas deklarimeve të personit nën hetim O. J., ai, së bashku me partnerë të tjerë, është i përfshirë në një projekt shumë të rëndësishëm, në vlera shumë të larta, në të cilin janë bërë pjesë edhe organet e qeverisjes vendore dhe asaj

qëndrore të RSH-së. Po sipas tij, me qëllim vënien në zbatim të këtij projekti, janë shpenzuar deri në 1.000.000 Euro dhe është krijuar edhe shoqëria “N... G... D...” shpk në Tiranë, duke mos u paraqitur asnjë provë në lidhje me këto shpenzime, burimin e tyre apo mënyrën e shpenzimit.

- Duke analizuar provat e administruara në gjykim, rezulton i bazuar dyshimi i organit të procedimit penal, në drejtim të veprimeve të kryera nga palët e përfshira në veprimtarinë e themelimit dhe transferimeve të kuotave të shoqërisë “NGD AS” në Norvegji. Kjo shoqëri, rezulton e themeluar në 23.11.2015, me kapital themeltar 30.000 Korona, përafërsisht me vlerë 3.800 Euro. O. J., pasi është bërë aksioner i shoqërisë për 90% të aksioneve, në datën 27 Janar 2016, kundrejt çmimit 2700 Euro, i ka shitur shtetasit J. B. N. 40% të këtyre aksioneve, me çmim 600.000 Euro në datën 01.03.2016. Transferimi i aksioneve të kësaj shoqërie në datën 01.03.2016, rezulton të jetë kryer në Tiranë dhe me çmim rreth 500 herë më të lartë se vlera fillestare e tyre, brënda përafërsisht 1 muaji. Nuk provohet në gjykim mënyra e rritjes së vlerës së këtyre aksioneve apo mënyra e reflektimit të këtyre transferimeve në regjistrat përkatës në vendin e themelimit dhe të ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë norvegjeze. Për më tepër, në analizë të parashikimeve të Statutit të “NGD AS”, në lidhje me transferimin e aksioneve, pika 6 e tij, rezulton që, transferimi i aksioneve të shoqërisë, realizohet kundrejt **njoftimit të shoqërisë dhe miratimit të saj për këtë transferim**, procedura të cilat nuk u arrit të provoheshin në gjykim.
- Themelimi i shoqërisë “NGD” shpk në Shqipëri në datën 02.02.2016, nuk rezulton të jetë pasuar me ndonjë aktivitet konkret të saj, deklarim punonjësish, blerje zyrash apo pajisjesh, kontribut të ortakut në kapitalin e shoqërisë, me qëllim vënien në zbatim të projektit të pretenduar etj. Në një kohë kur nga O. J.O. J.pretendohet se, për një periudhë rreth katër muaj nga themelimi, shoqëria do të realizonte një investim në shumën 800.000 Euro, sipas planit të investimit. Kapitali themeltar i shoqërisë mëmë norvegjeze, nuk rezulton të mbulojë këtë vlerë investimi të pretenduar. Për më tepër, selia ligjore e kësaj shoqërie, sipas deklarimit në aktet themeluese të depozituara në QKB, rezulton fiktiv nga verifikimet e organit procedues.
- Nga ana e Prokurorisë, janë marrë informacione zyrtare në organet homologe, edhe në drejtim të dëshmisë së penaltetit të shtetasit O. J., nga ku ai rezulton me rekorde kriminale në vite, kryesisht për mashtrime me kontabilitetin dhe aksionet, mashtrim me TVSH, evazion fiskal, në Norvegji, si dhe i dënuar në Kosovë, nën akuzën e organizimit të transfertave mashtruese prej 300.000 Euro, drejt një kompanie fantazëm në Norvegji, ndërsa për kërkuesin J. B. N., është referuar në informacionet e medias

norvegjeze, në lidhje me dyshimet mbi përfshirjen e tij në aktivitetin e dyshuar të skemave piramidale “Unaico”.

- Nga ana e kërkuarit nuk u arrit të provohej burimi i ligjshëm i shumave 200.000 Euro dhe 300.000 Euro, të sekuestruara me Vendimin e Prokurorisë datë 21.03.2016. Këto shuma, rezultojnë të transferuara nga llogaria personale e tij pranë “Union Bank of Filippines”, e cila, sipas provave të paraqitura prej kësaj pale në gjykim, është kredituar, nëpërmjet debitimit të llogarisë bankare të shoqërisë “A... C... G... Ltd”, Hong Kong, e zotëruar 100% prej J. B. N., regjistruar në datën 14.05.2015. Nuk rezulton i pasqyruar në këto akte qëllimi i këtij veprimi bankar. Më tej, duke iu referuar Kontratës së Shitjes së aksioneve të shoqërisë norvegjeze “NGD AS”, rezulton që J. B. N., të jetë bërë aksioner i saj në datën 01.03.2016 në 40% të aksioneve, kundrejt çmimit 600.000 Euro, nga të cilat, bëhet prezent se, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, t’i ketë paguar shitësit O. J.O. J.shumën 200.000 Euro, ndërsa diferencën do ta shlyente sipas udhëzimeve të këtij të fundit. Ndërkohë, në përshkrimin e transfertës në llogarinë bankare të O. J.O. J.pranë “Intesa SanPaolo Albania” sha, nga llogaria e kërkuarit në “Union Bank of Filippines”, rezulton që kjo shumë të ketë kaluar si investim kapitali. Në se do të pranohej pretendimi i kërkuarit se qëllimi i tij në të dy transfertat e sekuestruara, ka qënë pjesëmarrja në projektin e fushave të Golfit në Jug të Shqipërisë, këto shuma do të kalonin në llogari të shoqërisë bijë “NGD” shpk në Tiranë dhe jo në llogarinë personale të O. J.. Të gjitha veprimet e përshkruara më lart, të realizuara brënda një periudhe të shkurtër kohore, hedhin dyshime mbi konsumimin e elementëve të veprës penale të “Pastrimit të parave”.
- Pastrimi i parave, konceptohet si një veprim që “fsheh” me të gjitha mënyrat, madje edhe me justifikime të rreme, origjinën e pasurive, të të mirave dhe të të ardhurave, të autorit të një krimi apo të një shkeljeje ligjore, si rezultat i të cilave, ky i fundit ka përfituar shuma parash në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Pastrimi i parave si përkufizim, është procesi që synon të prezantojë si të ligjshme, fitime që janë realizuar në aktivitete të paligjshme. Në kuadër të kuptimit të veprës penale për të cilën kërkuari rezulton të jetë regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë si person nën hetim, nisur nga arsyetimi i mësipërm i fakteve të provuara si të dyshimta, Gjykata e gjen Vendimin datë 21.03.2016 të Prokurorisë të ligjshëm dhe të bazuar në dispozitat procedurale penale. Në përfundim të sa më lart, Gjykata konkludon në rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim J. B. N. të pabazuar dhe si të tillë e rrëzon atë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, konform neneve 210 dhe 212 të K.Pr.Penale

VENDOSI

- Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit J. B. N., për heqjen e masës së sekuestros vendosur mbi llogarinë e kërkuarit, pranë “Intesa SanPaolo Bank” sha, vendosur me Vendimin datë 21.03.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Shpenzimet gjyqësore kërkuarit.
- Kundër vendimit lejohet ankim brenda 10 (dhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, afat i cili për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mungesë në shpalljen e vendimit, fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më 05.10.2016

SEKRETARE

VALBONA SADIKU

GJYQTARE

BLERINA MUÇA